



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot.

Datë _____ / _____ / 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: BOE Boshnjaku B shpk dhe Desaret Company shpk

Adresa: Fier Lagjja Bishanake, Rruga Skenderbeu, Nr. 8, Prane karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr 8532

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-88396-02-25-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Furnizimi me ujë në zonat bregdetare, Plazhi I Gjeneralit – Bardhor – Karpen - Synej Bashkia Kavajë Varianti I, Loti I**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme, çmimi më i ulët

* * *

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Agi Kons shpk me NIPT K21622001M, vlera 127,084,729 lekë pa tvsh
2. BOE Boshnjaku B shpk me NIPT K72627402H dhe Desaret Company shpk me NIPT JK01816001J, vlera 157,699,830 lekë pa tvsh
3. BOE Nika shpk me NIPT J76705047U dhe Ndregjoni shpk me NIPT K31329048I, vlera 166,454,905.31 lekë pa tvsh

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Agi Kons shpk
2. BOE Nika shpk dhe Ndregjoni shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Agi Kons shpk
 - Ne piken 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Afati I perlllogaritjes se kontratave te ngjashme te vlefshme eshte tre vite nga data e hapjes se ofertave domethene 30.03.2018 deri 29.03.2021.

Nga operatori ekonomik Agi Kons shpk janë paraqitur:

1. kontrata me objekt "Rikonstruksion i rrjetit te furnizimit me uje te Qytetit Konispol" me vlere te realizuar te kontrates baze 186,901,165 leke me tvsh, afati 05.12.2016 – 28.02.2018. Kjo kontrate eshte realizuar jashte tre viteve te fundit, prandaj konsiderohet e pavlefshme si kontrate e ngjashme.
2. kontrata shtese me te njejtin objekt "Rikonstruksion i rrjetit te furnizimit me uje te Qytetit Konispol" me vlere te realizuar te kontrates 37,328,467 leke me tvsh, afati 26.10.2018 – 25.01.2019. Kjo kontrate nuk permbush kerkesat e pikes 2.3.1 si ne rastin e nje kontrate te vetme me vlere sa 50% e fondit limit.

Referuar sa me siper operatori ekonomik Agi Kons shpk nuk e permbush kerkesen sipas pikes 2.3.1 per kontratat per pune te ngjashme.

- Ne piken 2.2.3. kerkohet se operatoret ekonomike duhet te paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Gjate vitit 2020 operatori ekonomik Agi Kons shpk ka kryer aktivitet ne Bashkine Kamez referuar kontrates me objekt "Rindërtimi i një godine të re me 2-4 kate mbi tokë kryhen në objektin shkolla 9-vjecare "Halit Coka" Njësia Administrative Bathore, Bashkia Kamëz" e lidhur me date 09.06.2020. Duke qene se operatori ekonomik Agi Kons shpk ka kryer aktivitet ne territorin e Bashkise Kamez, keni patur detyrimin ligjor te benin shlyerjen e taksave per kete vit, prane kesaj bashkie, fakt i cilin nuk vertetohet me asnje dokument.

Nga sa me siper, operatori ekonomik Agi Kons shpk nuk e permbush kerkesen e pikes 2.2.3 per shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020.

- Ne piken 2.3.7. kerkohet se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për 1 (një) fabrikë betoni, 1 (një) fabrikë asfalti, per furnizimin me tubo RC dhe PE, për furnizimin me pajisjet elektrike dhe për furnizimin me pajisjet hidraulike.

Per te plotesuar kerkesen e kesaj pike operatori ekonomik Agi Kons shpk nuk ka paraqitur asnje kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi.

Nga sa me siper, nuk permbushet kerkesa e pikes 2.3.7. e kriterave të vecanta të kualifikimit.

2. BOE Nika shpk dhe Ndrejoni shpk

- Ne piken 2.2.3. kerkohet se operatoret ekonomike duhet te paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se keni paraqitur punë të ngjashme në territorin e Bashkisë Lushnje me objekt Rehabilitimi i Skemës së vaditjes Murriz-Thana-Krutja ndërkohë nuk keni paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.

- Referuar Shtojcës 11 (deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces) operatori ekonomik Nika shpk ka deklaruar punime në proces të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me objekt “Ndërtim ujësjellësi Bajzë, Malësi e Madhe” me vlerë 322.507.370 lekë ku ju keni 37.58% ose 121,198,270 lekë dhe “Ndërtim ujësjellësi Maçurisht-Plazë” me vlerë 159.098.275 ku ju keni 51.1% ose 81,299,218 lekë. Në total janë deklaruar punime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 202,497,489 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik Nika shpk është pajisur me Kategorinë NP7 Niveli C të licensës profesionale (Vlera për nivelin C është nga 50-100 milion lekë).

Referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 8/d) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licensës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Për sa më sipër operatori ekonomik Nika shpk deklaron punime në process mbi kufirin maksimal të licensës profesionale.

- Ne piken 2.3.7. kerkohet se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

1. Për tubo RC dhe PE. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisjet duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Katalogu dhe Certifikatat Iso nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe.

2. Për pajisjet elektrike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisjet elektrike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kontrata e furnizimit është e nënshkruar me Sali Elektrik ndërkohë që Çertifikatat ISO nuk lidhen me furnitorin dhe janë gjithashtu të papërkthyer në gjuhën shqipe.

3. Për pajisjet hidraulike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisjet hidraulike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001(Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Nuk është paraqitur katalog për Elektropompat dhe Autorizimi I prodhuesit nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se BOE Boshnjaku B shpk dhe Desaret Company shpk me adrese Fier Lagjja Bishanake, Rruga Skenderbeu, Nr. 8, Prane karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr 8532, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej

157,699,830 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.04.2021

Ankesa: Ka patur, ka marrë përgjigje në datë 20.04.2021

Kryetari

Redjan KRALI